

VENDIM
Nr. 386, datë 2.5.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE BRENDË PROGRAMEVE TË MIRATUARA
PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, NË BUXHETIN E VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore, në buxhetin e vitit 2013, zëri “Shpenzime korente”, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, si më poshtë vijon:

- a) programit të sistemit të burgjeve t’i pakësohet fondi prej 7 150 000 (shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për shpenzime personeli;
- b) programit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor t’i pakësohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për shpenzime personeli;
- c) programit të Shërbimit të Provës t’i shtohet fondi prej 9 150 000 (nëntë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për shpenzime personeli.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha